



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Për Shtyp

Rasti: Përftim i kontrollit të shoqërisë ALH Group SHPK nga shoqëria Lufthansa Industry Solutions AS GmbH.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është protokolluar nga AK, shkresa me Nr.123 Prot., datë 06.02.2019, “Shkresë përcjellëse për depozitimin e një njoftimi përqendrimi”, ku përfaqësuesi ligjor “HM &H” ka njoftuar në lidhje me transaksionin që do të rezultojë lidhur me përftimin e kontrollit të drejtpërdrejtë nga shoqëria Lufthansa Industry Solutions AS GmbH mbi shoqërinë ALH Group SHPK dhe kontrollit të tërthortë mbi ndërmarrjen Applications Management Development, e cila kontrollohet tërësisht nga shoqëria ALH Group SHPK”.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Referuar “Marrëveshje për shitjen dhe blerjen e të gjithë kuotës së kapitalit të ALH Group SHPK” palët në marrëveshje janë:

Blerësi: Lufthansa Industry Solutions AS GmbH, është një shoqëri, me objekt veprimtarie: Ofrim i shërbimeve të sistemit të teknologjisë së informacionit, në veçanti zhvillimi i softuerit dhe shërbime të tilla konsulencia, shërbimet e infrastrukturës dhe shërbimet e komunikimit.

Shitësi/Target ALH Group SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt veprimtarie: shërbime inxhinierike dhe konsulencë, zhvillim software dhe programim, blerje kompanish ose biznese në fusha të ngjajshme. Marrje me qera ose blerje e hapësirave për publicitet dhe kryerja dhe/ose organizimi i aktiviteteve promovionale, zhvillimi i projekteve, menaxhimi dhe realizimi i projekteve, blerje dhe çdo lloj aktiviteti tjetër që nuk është i ndaluar me ligj, etj.

Shoqëria ALH Group SHPK zotërohet nga Z.Minella Gjoka (zotëron 1/3 e kapitalit të shoqërisë), Z.Robert Felix Kubera (zotëron 1/3 e kapitalit të shoqërisë), dhe Z.Uwe Fischer (zotëron 1/3 e kapitalit të shoqërisë). Shoqëria ALH Group SHPK, është mbajtësja e vetme ligjore e shoqërisë Applications Management Development-AMD SHPK, duke përfaqësuar 100% të kapitalit të kuotave të kësaj të fundit.

Shoqëria ALH Group SHPK nuk kryen aktivitet ekonomik por ajo është vetëm zotëruese e kuotave të shoqërisë Applications Management Development-AMD SHPK.

Shoqëria Applications Management Development-AMD SHPK, është themeluar sipas legjislacionit shqiptar me përgjegjësi të kufizuar, me ortak të vetëm shoqërinë ALH Group SHPK.

Shoqëria Applications Management Development-AMD SHPK, nuk zotëron direkt apo indirekt asnjë interes në ndonjë shoqëri, partneritet, sipërmarrje të përbashkët ose entitet biznesi.

Më datë 25 janar 2019, në shtetin Gjerman është nënshkruar “Marrëveshje për shitjen dhe blerjen e të gjithë kuotës së kapitalit të ALH Group SHPK”, nga shoqëria blerëse Lufthansa Industry Solutions AS GmbH dhe pala shitëse e përfaqësuar nga aksioneri i shoqërisë ALH Group SHPK Z.Robert Felix Kubera, i cili përfaqëson në marrëveshje Z.Uwe Fischer dhe Z.Minella Gjoka, në përputhje me prokurën datë 18.01.2019.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fiton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.